

Sot në hapësirat e Kuvendit të Kosovës janë takuar liderët e koalicionit LVAN. Në takim ishin Isa Mustafa (LDK), Albin Kurti (LVV), Ramush Haradinaj (AAK) dhe Fatmir Limaj (Nisma)

Në emër të tyre foli kreu i Nismës për Kosovën, Fatmir Limaj, i cili tha se blloku nuk do të insistojë më për postin kryeparlamentarit.

Edhe dje është raportuar se LVAN-i sot mund ta bëjë publik këtë pozicion . Por, siç u tha dje, edhe sot pas takimit u theksua se blloku ka kërkuar garanci nga presidentja se herën e dytë do t'u takojë atyre e drejta për të formuar Qeverinë, pasi mundësinë e parë ta ketë shteruar PDK-ja e Thaçit.

Limaj ka thënë se i kanë dërguar një letër presidentes Atifete Jahjaga, me propozim konkret për zgjidhjen e ngërçit. Ai tha se përmes kësaj letre kanë kërkuar nga Jahjaga që të thërras urgjentisht seancën e Kuvendit në të cilën deputetët e LVAN-it do ta votojnë kryeparlamentarin e PDK-së, për t'i hapur rrugë Qeverisë së Bllokut. /Telegrafi/